



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në Nenin 57, Shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-391, si dhe bazuar në Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në funksion të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit në institucionet edukativo-arsimore e aftësuese (IEAA) të Komunës së Prishtinës, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) merr:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINËS - OPŠTINA PRISHTINA
DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË-DIREKCIJA ZA PROSVETU I KULTURU

V E N D I M

03 Nr./Bf. 47 Dt. 04.06.2014

**PËR MËNYRËN E PRANIMIT TË NXËNËSVE NË SHKOLLAT FILLORE
NË KLASËN E PARË OSE PARAFILLORËT DHE NDARJEN E TYRE NËPËR KLASË**

Të gjitha shkollat fillore të Komunës së Prishtinës, me rastin e regjistrimit të nxënësve në klasën e parë apo në klasët parafillore duhet:

1. Të respektojnë zonimin dhe çdo prind që bën kërkesë për të regjistruar fëmijën në shkollën përkatëse duhet të sjellë dëshmi se është banor i lagjes/fshatit që është në kuadër të zonës që mbulohet nga shkolla përkatëse. Nëse lagja/fshati nuk ka shkollë dhe prindërit nuk punojnë, fëmija regjistrohen në shkollën më të afërt nga vendbanimi, ndërsa nëse prindërit punojnë, atëherë fëmija mund të regjistrohet në shkollën që është afër vend-punës së prindërve.
2. Të mos lejojnë dallime të mëdha në numrin e nxënësve në mes të paraleleve. Dallimi më i madh i lejueshëm në mes të paraleleve mund të jetë 5 nxënës.
3. Drejtorja e shkollës duhet të vendosë për kriteret e ndarjes së nxënësve nëpër paralele, duke siguruar po ashtu edhe proporcionin gjinor brenda të njëjtës klasë dhe në mes të paraleleve.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Drejtorive të IEAA
- DKA-së
- QSHQK

Drejtori
Jusuf Thaçi
Jusuf Thaçi
Prishtinë, më

2 qershor 2014